VENDIM
Nr. 779, datë 19.12.2025

PËR MIRATIMIN E TARIFËS SË BILETËS PËR QENDRËN KOMBËTARE TË KULTURËS PËR FËMIJË DHE TEATRIN E KUKULLAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 12, të ligjit nr. 10352, datë 18.11.2010, "Për artin dhe kulturën", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI**:**

1. Miratimin e tarifës së biletës për Qendrën Kombëtare të Kulturës për Fëmijë dhe Teatrin e Kukullave, sipas tabelave në shtojcat nr. 1 dhe nr. 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi.
2. Të ardhurat e realizuara nga shitja e biletave përdoren:
a) 30% për llogari të Qendrës Kombëtare të Kulturës për Fëmijë dhe Teatrit të Kukullave;
b) 70 % derdhen në buxhetin e shtetit.
3. Të ardhurat e Qendrës Kombëtare të Kulturës për Fëmijë dhe Teatrit të Kukullave nga shitja e biletave përdoren për veprimtarinë e tyre artistike dhe edukative.
4. Aktet për miratimin e tarifave për Qendrën Kombëtare të Kulturës për Fëmijë dhe Teatrin e Kukullave, të miratuara përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohen.
5. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit dhe Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë dhe Teatri i Kukullave për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCA NR. 1
ÇMIMET E BILETËS PËR QENDRËN KOMBËTARE TË KULTURËS PËR FËMIJË DHE TEATRIT TË KUKULLAVE

Nr.	**Kategoria e biletës**	**Çmimi**
1	Shfaqjet me kukulla për fëmijë	300 lekë
2	Shfaqjet premierë absolute për fëmijë*	500 lekë
3	Shfaqjet për të rinjtë (+16 vjeç):	600 lekë
4	Mbrëmjet gala, spektakle dhe evente të tjera*	800 lekë

SHTOJCA NR. 2
ÇMIMET E BILETAVE PËR KATEGORITË SOCIALE

Nr.	**Kategoria sociale**	**Çmimi**
1	Fëmijët me aftësi të kufizuara	Falas